



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



DREJTORIA E FINANCIVE

DATA/DATUM/DATE	15.07.2026
NR/BR.	01 Nr.193/26
PËR/ZATO	Kuvendin e Komunës, Komitetin për Politikë dhe Financa
PËRMES/PREKO/THROUGH	z. Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit
NGA/OD/FROM	z. Agim Aliu, Kryetar i Komunës
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2026

I nderuar Kryesues i Kuvendit,
 Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal dhe anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa,
 Në përputhje me obligimet ligjore dhe rregullative në fuqi, si dhe në kuadër të raportimit të rregullt financiar, ju përcjellim Raportin Financiar për periudhën Janar–Qershor 2026. Ky raport paraqet gjendjen e realizimit të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore dhe ofron një pasqyrë të përgjithshme të performancës financiare të komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



RAPORTI FINANCIAR JANAR – QERSHOR 2026

F E R I Z A J
KORRIK 2026

Tabela e Përmbajtjes

1. Letër përcjellëse / Hyrje institucionale
2. Përmbledhje ekzekutive
3. Metodologjia dhe baza ligjore
4. Analiza e të hyrave vetanake (THV)
5. Analiza e tatimit në pronë sipas muajve
6. Inkasimi i THV sipas programeve
7. Analiza e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike
8. Analiza e shpenzimeve sipas programeve kryesore
9. Burimet e financimit dhe struktura GQ/THV
10. Vlerësimi i performancës buxhetore dhe faktorët ndikues
11. Rreziqet, implikimet dhe çështjet për menaxhim
12. Përfundime
13. Shtojca A - Tabela e plotë e të hyrave vetanake sipas kodeve ekonomike
14. Shtojca B - Inkasimi i THV sipas programeve dhe tabela përmbledhëse

1. Letër përcjellëse / Hyrje institucionale

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa,

Bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, përkatësisht Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin mbi Financat Lokale si dhe Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, paraqesim raportin financiar të organizatës buxhetore 656 për periudhën gjashtëmujore Janar–Qershor 2026.

Raporti jep një pasqyrë të detajuar të ecurisë financiare të Komunës së Ferizajt, duke përfshirë realizimin e të hyrave vetanake, shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe programeve, burimet e financimit, si dhe krahasimin me të njëjtën periudhë të vitit 2025. Qëllimi është të sigurohet transparencë fiskale dhe të mbështetet vendimmarrja për pjesën e mbetur të vitit.

Gjashtëmujori i parë karakterizohet nga realizim i ulët i të hyrave vetanake ndaj planit vjetor, rënie e theksuar e të hyrave nga planifikimi urban, rikuperim i dukshëm i tatimit në pronë gjatë muajit qershor dhe ritëm i lartë i ekzekutimit në disa kategori të shpenzimeve. Këto zhvillime kërkojnë kontroll të përforcuar financiar në gjashtëmujorin e dytë.

2. Përmbledhje ekzekutive

Performanca financiare e Komunës së Ferizajt për periudhën Janar–Qershor 2026 paraqet një hendek të konsiderueshëm në inkasimin e të hyrave vetanake dhe një ritëm të lartë të ekzekutimit të shpenzimeve. Buxheti total i miratuar për vitin 2026 është 53,068,494.00€.

3,103,299.59 €

TË HYRAT GJITHSEJ (6M)

-54.02%RËNIA E TË HYRAVE NDAJ 6M
2025**40.51%**

REALIZIMI NDAJ PLANIT

53,068,494.00€

BUXHETI TOTAL 2026

35,328,343.36 €

SHPENZIMI TOTAL (6M)

66.57%SHKALLA E SHPENZIMIT TË
BUXHETIT

PASQYRË E PERFORMANCËS FINANCIARE

- Gjatë periudhës raportuese, të hyrat e përgjithshme kanë arritur në 3,103,299.59€, ose 40.51% të planit vjetor, duke shënuar rënie prej 54.02% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025.
- Realizimi total i shpenzimeve ka arritur në 35,328,343.36€, ose 66.57% të buxhetit vjetor; krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2025 është shënuar rritje prej 9.38%.
- Hendeku i të hyrave vjen kryesisht nga rënia e Planifikimit Urban. Të hyrat indirekte nga gjobat arritën 937,703.64€ dhe zbutën pjesërisht rënien, ndërsa tatimi në pronë shënoi rikuperim të fortë në qershor.

3. Metodologjia dhe baza ligjore

Ky raport është përgatitur sipas parimit të kontabilitetit në para të gatshme (cash-basis), në përputhje me standardet e raportimit financiar të organizatave buxhetore. Shifrat paraqesin hyrjet dhe daljet faktike të mjeteve gjatë periudhës 1 janar – 30 qershor 2026.

Të dhënat janë marrë nga tabelat financiare të Drejtorisë së Financave dhe nga Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK). Krahasset janë bërë me planin vjetor 2026 dhe me realizimin Janar–Qershor 2025.

4. Analiza e të hyrave vetanake sipas kodeve ekonomike

Plani vjetor i të hyrave vetanake për vitin 2026 është 7,660,269.00€. Gjatë periudhës Janar–Qershor, komuna ka realizuar gjithsej 3,103,299.59€, prej të cilave 2,165,595.95€ janë të hyra vetanake programore dhe 937,703.64€ janë të hyra indirekte nga gjobat e trafikut, gjykatës dhe APK-së. Realizimi i përgjithshëm është 40.51% i planit vjetor. Krahësuar me 6,749,862.61€ në të njëjtën periudhë të vitit 2025, rënia është 54.02%.

PIKAT E VËMENDJES MENAXHERIALE

Ndikimi kryesor vjen nga kodi ekonomik 50009 (Taksa për leje ndërtimi). Realizimi Janar–Qershor 2026 ishte 497,363.14€, kundrejt 3,753,837.75€ në vitin 2025, ose rënie prej 86.75%. Tatimi në pronë realizoi 1,010,678.16€ dhe mbeti 28.58% nën vitin paraprak.

Në tabelën vijuese paraqiten të gjitha kodet ekonomike, përfshirë zërat me vlera të vogla dhe të hyrat indirekte të evidentuara në tabelën burimore, në mënyrë që totalët të barazohen me shumën e të gjitha zërave:

Kodi	Emërtimi i Të Hyrave	Planifikimi 2026 (€)	Realizimi Jan-Qer 2026 (€)	Realizimi Jan-Qer 2025 (€)	% Ndaj Planit
40110	Tatimi në pronë	3,274,540.00	1,010,678.16	1,415,021.82	30.86%
50001	Taksa-Regjistrimi i automjeteve	370,000.00	206,850.00	205,392.33	55.91%
50005	Taksa e lejeve të vozitjes	10,000.00	7,456.65	3,348.00	74.57%
50009	Taksa për leje ndërtimi	2,100,000.00	497,363.14	3,753,837.75	23.68%
50013	Taksa për çertifikatat e lindjes	65,000.00	34,242.00	31,249.00	52.68%
50014	Taksa për çertifikatat e kurorëzimit	12,000.00	3,955.00	4,090.00	32.96%
50015	Taksa për çertifikatat e vdekjes	8,000.00	461.00	587.00	5.76%
50016	Taksa për çertifikata tjera	15,000.00	731.00	436.00	4.87%
50017	Taksa për verifikimin e dokumenteve të ndryshme	40,000.00	290.00	183.00	0.73%
50019	Taksa tjera administrative	130,000.00	0.00	0.00	0.00%
50026	Taksa për legalizimin e objekteve	330,000.00	12,083.17	30,484.41	3.66%

Kodi	Emërtimi i Të Hyrave	Planifikimi 2026 (€)	Realizimi Jan-Qer 2026 (€)	Realizimi Jan-Qer 2025 (€)	% Ndaj Planit
50032	Taksa për certifikatë të pronësisë dhe kopje plani	30,000.00	19,842.00	1,117.00	66.14%
50045	Leje mjedisore komunale	580,000.00	96,421.03	202,454.41	16.62%
50104	Gjobat nga Inspektorati	30,000.00	4,775.00	7,004.95	15.92%
50107	Gjobat tjera	10,000.00	6,330.01	3,905.33	63.30%
50111	Shitja e pasurisë së konfiskuar	0.00	3,500.00	0.00	–
50114	Gjoha mandatorë – Hedhja e mbeturinave	5,000.00	1,245.00	105.00	24.90%
50205	Licenca për pranim teknik të lokalit	5,000.00	1,105.00	1,595.00	22.10%
50408	Qiraja nga objektet publike	130,000.00	28,836.87	24,761.53	22.18%
50409	Participimet	265,729.00	154,463.40	145,269.60	58.13%
50433	Të hyrat nga shërbimet e autobartjes	0.00	526.52	0.00	–
50504	Taksa për matje e tokës në teren	250,000.00	74,441.00	103,271.00	29.78%
/	Gjobat e trafikut	–	875,141.50	763,802.00	–
/	Gjobat nga gjykata	–	60,640.00	51,635.00	–
/	Gjobat nga APK	–	1,922.14	312.48	–
TOTALI I TË HYRAVE		7,660,269.00	3,103,299.59	6,749,862.61	40.51%

Burimi: Të dhënat financiare të Komunës së Ferizajt, Janar–Qershor 2026 (tabela e plotë e kodeve ekonomike dhe e të hyrave indirekte).

5. Analiza e tatimit në pronë sipas muajve

Tatimi në pronë mbetet burimi më i madh i qëndrueshëm i të hyrave komunale. Gjatë periudhës 1 janar – 30 qershor 2026 janë realizuar 1,010,678.16€, kundrejt 1,415,021.82€ në vitin 2025, që përfaqëson rënie prej 28.58%.

Muaji	Realizimi 2025 (€)	Realizimi 2026 (€)	Diferenca (%)
Janar	84,018.04	79,935.52	-4.86%
Shkurt	204,953.79	65,039.19	-68.27%
Mars	188,318.22	43,876.58	-76.70%
Prill	513,546.66	329,709.32	-35.80%
Maj	280,332.61	180,156.10	-35.73%
Qershor	143,852.50	311,961.45	116.86%
Gjithsej	1,415,021.82	1,010,678.16	-28.58%

Ecuria mujore tregon se rënia është përqendruar në muajt shkurt–maj. Muaji qershor shënoi kthesë të fortë, me 311,961.45€ të inkasuara kundrejt 143,852.50€ në qershor 2025, ose rritje prej 116.86%.

Rritja e qershorit sinjalizon përmirësim të ritmit të arkëtimit, por nuk ka kompensuar deficitin e akumuluar gjatë pesë muajve të parë. Për gjashtëmujorin e dytë kërkohet monitorim i arkëtimit dhe detyrimeve të papaguara.

6. Inkasimi i THV sipas programeve

Zbërthimi i të hyrave vetanake sipas programeve paraqet të gjitha programet e evidentuara në tabelën burimore. Rënia mbetet e përqendruar kryesisht në Planifikimin Urban dhe Tatimin në Pronë. Totali programor prej 2,165,595.95€ nuk përfshin të hyrat indirekte nga trafiku, gjykata dhe APK, të cilat paraqiten veçmas në pikën 4 dhe arrijnë 937,703.64€.

Programi / Sektori	Kodi	Realizimi Jan-Qer 2025 (€)	Realizimi Jan-Qer 2026 (€)	Diferenca (€)
Administrata	16332	39,035.00	41,391.00	+2,356.00
Prokurimi	16860	0.00	3,500.00	+3,500.00
Buxheti	17532	237,228.81	241,566.87	+4,338.06
Tatimi në pronë	17572	1,415,021.82	1,010,678.16	-404,343.66
Shërbimet publike	18032	3,383.00	9,228.17	+5,845.17
Pylltaria	47112	1,415.33	4,618.01	+3,202.68
Shërbimet Kadastrale	65160	104,388.00	94,283.00	-10,105.00
Planifikimi Urban	66465	3,988,371.57	605,867.34	-3,382,504.23
Shërbimet e kujdesit primar shëndetësor	74900	59,578.00	63,475.50	+3,897.50
Shërbimet kulturore	85032	1,946.00	1,497.00	-449.00
Teatri	85223	780.10	1,214.50	+434.40
Arsimi parafillor – çerdhet	92830	81,294.50	81,585.40	+290.90
Arsimi i mesëm	95130	1,665.00	6,655.00	+4,990.00
Shkolla e mesme "Pjetër Bogdani"	95132	6.00	36.00	+30.00
TOTALI PËR TË GJITHA PROGRAMET		5,934,113.13	2,165,595.95	-3,768,517.18

Planifikimi Urban ka rënë për 3,382,504.23€ dhe përbën rreth 89.76% të rënies së përgjithshme programore. Tatimi në Pronë ka rënë për 404,343.66€, ndërsa disa programe kanë shënuar rritje të moderuar, përfshirë Shërbimet Publike, Buxhetin dhe Kujdesin Primar Shëndetësor.

7. Analiza e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike

Nga buxheti i miratuar prej 53,068,494.00€, komuna ka shpenzuar 35,328,343.36€ gjatë periudhës Janar–Qershor, duke arritur shkallë ekzekutimi prej 66.57%. Shpenzimet janë financuar nga Granti Qeveritar dhe Të Hyrat Vetanake.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, shpenzimet janë rritur për 3,030,849.72€, ose 9.38%. Ritmi më i lartë i ekzekutimit evidentohet te shpenzimet komunale, mallrat dhe shërbimet dhe investimet kapitale, duke rritur nevojën për kontroll të zotimeve në pjesën e mbetur të vitit.

Kategoria Ekonomike	Buxheti i Miratuar 2026 (€)	Shpenzimi Jan-Qer 2026 (€)	Shkalla e Ekzekutimit (%)	
Pagat dhe Mëditjet	23,623,853.00	13,628,879.02	57.69%	
Mallra dhe Shërbime	11,519,945.00	9,226,606.73	80.09%	
Shpenzim e Komunale	1,010,982.00	975,240.73	96.46%	
Subvencione dhe Transfere	2,500,000.00	978,797.72	39.15%	
Investime Kapitale	14,413,714.00	10,518,819.16	72.98%	
TOTALI I SHPENZIMEVE	53,068,494.00	35,328,343.36	66.57%	

RITMI I EKZEKUTIMIT BUXHETOR

Ekzekutimi i përgjithshëm ka arritur 66.57% në fund të gjashtëmuorit. Shpenzimet komunale janë realizuar 96.46%, mallrat dhe shërbimet 80.09% dhe investimet kapitale 72.98%. Këto nivele kërkojnë kontroll të rreptë të zotimeve, faturave dhe buxhetit të mbetur për gjashtëmuorin e dytë.

8. Analiza e shpenzimeve sipas programeve kryesore

Ndarja e shpenzimeve sipas programeve reflekton prioritetet kryesore institucionale. Tabela paraqet programet me peshën më të madhe në shpenzimet e përgjithshme të gjashtëmujorit.

Programi / Sektori	Buxheti 2026 (€)	Shpenzimi Jan-Qer 2026 (€)	% e Totalit të Shpenzimeve
Arsimi	21,016,732.84	12,812,675.21	36.27%
Infrastruktura Publike	7,593,346.71	5,762,902.73	16.31%
Shërbime Publike dhe Mbrojtja Civile	4,881,007.07	3,785,615.07	10.72%
Shëndetësia	6,121,960.59	3,598,815.90	10.19%
Administrata dhe Personeli	4,052,299.24	3,383,082.74	9.58%
Bujqësia	2,297,883.80	1,050,664.16	2.97%
Kultura, Rini dhe Sport	1,384,082.02	1,008,358.16	2.85%

Arsimi përbën programin më të madh me 12,812,675.21€, ose 36.27% të totalit. Arsimi, Infrastruktura Publike, Shërbimet Publike, Shëndetësia dhe Administrata së bashku përbëjnë 83.06% të shpenzimeve. Ekzekutimi i lartë në disa programe kërkon vlerësim të buxhetit të mbetur dhe të obligimeve për gjashtëmujorin e dytë.

9. Burimet e financimit dhe struktura GQ/THV

Gjatë periudhës raportuese, shpenzimet u mbështetën kryesisht në fondet e transferuara nga niveli qendror, ndërsa pjesëmarrja e të hyrave vetanake mbeti e kufizuar.

- **Granti Qeveritar (GQ):** Financoi 33,871,741.19€, ose 95.88% të shpenzimeve totale.
- **Të Hyrat Vetanake (THV):** Financuan 1,456,602.17€, ose 4.12% të ekzekutimit të përgjithshëm të shpenzimeve.

10. Vlerësimi i performancës dhe rreziqet e menaxhimit fiskal

Në fund të gjashtëmujorit të parë, të hyrat vetanake programore kanë arritur 28.27% të planit vjetor, ndërsa të hyrat e përgjithshme, pas përfshirjes së të hyrave indirekte nga gjobat, arrijnë 40.51% të planit. Ekzekutimi i shpenzimeve ka arritur 66.57%. Ky raport ndërmjet arkëtimeve dhe shpenzimeve paraqet sfidën kryesore për menaxhimin fiskal në pjesën e mbetur të vitit. Rreziqet dhe faktorët kryesorë janë:

- **Rreziku i të hyrave vetanake:** Realizimi programor prej 28.27% mbetet nën ritmin proporcional të gjashtëmujorit; përfshirja e të hyrave indirekte e ngre realizimin e përgjithshëm në 40.51% të planit, por hendeku mbetet i konsiderueshëm.
- **Presioni mbi kategoritë me ekzekutim të lartë:** Shpenzimet komunale kanë arritur 96.46%, mallrat dhe shërbimet 80.09%, ndërsa investimet kapitale 72.98% të buxhetit vjetor.
- **Varësia nga të hyrat jo-lineare:** Të hyrat nga lejet e ndërtimit dhe planifikimi urban kanë luhajtje të lartë dhe kanë prodhuar pjesën kryesore të rënies krahasuese.
- **Të hyrat indirekte:** Gjatë periudhës Janar–Qershor 2026 janë evidentuar 937,703.64€ nga gjobat e trafikut, gjykatës dhe APK-së, kundrejt 815,749.48€ në vitin 2025. Kjo paraqet rritje prej 14.95% dhe ka zbutur rënien e përgjithshme të të hyrave.
- **Sinjali pozitiv i tatimit në pronë:** Rritja prej 116.86% në qershor tregon potencial rikuperimi, por kërkon vazhdimësi të inkasimit gjatë muajve vijues.

PIKAT E VËMENDJES MENAXHERIALE

Rekomandohet monitorim javor i zotimeve dhe shpenzimeve, përditësim mujor i planit të rrjedhës së parasë, plan veprimi për të hyrat nga planifikimi urban dhe tatimi në pronë, si dhe rakordim i plotë i të hyrave indirekte me SIMFK dhe institucionet përkatëse.

11. Rreziqet, implikimet dhe çështjet për menaxhim

Gjatë periudhës Janar–Qershor 2026, të dhënat financiare evidentojnë rreziqe të lidhura njëkohësisht me nivelin e arkëtimit, ritmin e shpenzimeve dhe përqendrimin e të hyrave në pak zëra me luhatje të lartë. Menaxhimi i këtyre rreziqeve është vendimtar për ruajtjen e likuiditetit dhe për realizimin e prioritetëve komunale deri në fund të vitit.

Fusha e rrezikut	Përshkrimi i implikimit	Ndikimi potencial	Qasja e rekomanduar e menaxhimit
Likuiditeti dhe THV	Realizimi programor i THV është 28.27%, ndërsa realizimi i përgjithshëm me të hyrat indirekte arrin 40.51% të planit vjetor.	Kufizim i financimit të aktiviteteve nga burimet vetanake.	Parashikim mujor i arkëtimeve, plan i rrjedhës së parasë dhe priorizim i pagesave.
Ritmi i shpenzimeve	Ekzekutimi total është 66.57%; komunal 96.46% dhe mallrat 80.09%.	Rrezik i pamjaftueshmërisë së buxhetit në gjashtëmujorin e dytë.	Monitorim javor i zotimeve, kufij të brendshëm dhe rialokime të hershme kur nevojiten.
Planifikimi urban	Të hyrat ranë nga 3.99 mil.€ në 0.61 mil.€.	Hendek i madh në realizimin e planit dhe paqëndrueshmëri e arkëtimeve.	Analizë e lejeve aktive, afateve të pagesës dhe përditësim i parashikimit të të hyrave.
Investimet kapitale	Ekzekutimi ka arritur 72.98% të buxhetit vjetor.	Përqendrim i obligimeve dhe presion mbi fondet e mbetura.	Rakordim i kontratave, faturave dhe planit të prokurimit me buxhetin e mbetur.
Të hyrat indirekte	Në vitin 2026 janë evidentuar 937,703.64€, kundrejt 815,749.48€ në vitin 2025.	Rritje prej 14.95% dhe zbutje e rënies së përgjithshme të të hyrave.	Raportim i veçantë dhe rakordim periodik me SIMFK dhe institucionet përkatëse.

Për gjashtëmujorin e dytë rekomandohet monitorim javor i zotimeve dhe pagesave, përditësim mujor i parashikimit të arkëtimeve, rakordim i të hyrave indirekte me institucionet përkatëse dhe ndërhyrje e hershme përmes rialokimeve kur rrezikohet tejkalimi i kategorive buxhetore.

12. Përfundime

Raporti financiar për periudhën Janar–Qershor 2026 tregon se Komuna e Ferizajt ka realizuar 66.57% të buxhetit vjetor, ndërsa të hyrat vetanake programore kanë arritur 28.27% të planit. Të hyrat e përgjithshme, përfshirë gjokat e trafikut, gjykatës dhe APK-së, kanë arritur 3,103,299.59€, ose 40.51% të planit. Shpenzimet janë rritur 9.38% krahasuar me vitin 2025, ndërsa të hyrat e përgjithshme krahasuese kanë rënë 54.02%.

Rënia e të hyrave lidhet kryesisht me Planifikimin Urban. Në të kundërt, të hyrat indirekte nga gjokat e trafikut, gjykatës dhe APK-së arritën 937,703.64€, ose 14.95% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 2025. Tatimi në pronë mbetet nën nivelin e vitit paraprak, megjithëse rritja e fortë në qershor ofron bazë për përmirësim të mëtejshëm.

Prioritetet për gjashtëmujorin e dytë janë përsheptimi i arkëtimeve, ruajtja e kontrollit mbi kategoritë me ekzekutim të lartë, verifikimi i obligimeve kontraktuale dhe përditësimi i parashikimit financiar deri në fund të vitit. Kjo qasje është e nevojshme për të ruajtur likuiditetin dhe vazhdimësinë e shërbimeve publike.

Burimi: Të dhënat financiare të Komunës së Ferizajt, Janar–Qershor 2026.

13. Shtojca A – Tabela e plotë e të hyrave vetanake sipas kodeve ekonomike

Kodi ekonomik	Emërtimi	Planifikimi THV 2026 (€)	Realizimi Jan-Qer 2026 (€)	Diferenca plan/realizim (€)	Realizimi Jan-Qer 2025 (€)	% 2026/2025
40110	Tatimi në pronë	3,274,540.00	1,010,678.16	2,263,861.84	1,415,021.82	71.42
50001	Taksa-Regjistrimi i automjeteve	370,000.00	206,850.00	163,150.00	205,392.33	100.71
50005	Taksa e lejeve të vozitjes	10,000.00	7,456.65	2,543.35	3,348.00	222.72
50009	Taksa për leje ndërtimi	2,100,000.00	497,363.14	1,602,636.86	3,753,837.75	13.25
50013	Taksa për çertifikatat e lindjes	65,000.00	34,242.00	30,758.00	31,249.00	109.58
50014	Taksa për çertifikatat e kurorëzimit	12,000.00	3,955.00	8,045.00	4,090.00	96.70
50015	Taksa për çertifikatat e vdekjes	8,000.00	461.00	7,539.00	587.00	78.53
50016	Taksa për çertifikata tjera	15,000.00	731.00	14,269.00	436.00	167.66
50017	Taksa për verifikimin e dokumenteve të ndryshme	40,000.00	290.00	39,710.00	183.00	158.47
50019	Taksa tjera administrative	130,000.00	0.00	130,000.00	0.00	–
50026	Taksa për legalizimin e objekteve	330,000.00	12,083.17	317,916.83	30,484.41	39.64
50032	Taksa për certifikatë të pronësisë dhe kopje plani	30,000.00	19,842.00	10,158.00	1,117.00	1776.37
50045	Leje mjedisor e komunal e	580,000.00	96,421.03	483,578.97	202,454.41	47.63
50104	Gjobat nga Inspektori	30,000.00	4,775.00	25,225.00	7,004.95	68.17
50107	Gjobat tjera	10,000.00	6,330.01	3,669.99	3,905.33	162.09

50111	Shitja e pasurisë së konfiskuar	0.00	3,500.00	-3,500.00	0.00	–
50114	Gjoba mandatorë – Hedhja e mbeturinave	5,000.00	1,245.00	3,755.00	105.00	1185.71
50205	Licenca për pranim teknik të lokalit	5,000.00	1,105.00	3,895.00	1,595.00	69.28
50408	Qiraja nga objektet publike	130,000.00	28,836.87	101,163.13	24,761.53	116.46
50409	Participimet	265,729.00	154,463.40	111,265.60	145,269.60	106.33
50433	Të hyrat nga shërbimet e autobartjes	0.00	526.52	-526.52	0.00	–
50504	Taksa për matje e tokës në teren	250,000.00	74,441.00	175,559.00	103,271.00	72.08
/	Gjobat e trafikut	/	875,141.50	/	763,802.00	114.58
/	Gjobat nga gjykata	/	60,640.00	/	51,635.00	117.44
/	Gjobat nga APK	/	1,922.14	/	312.48	615.12
Totali		7,660,269.00	3,103,299.59	4,556,969.41	6,749,862.61	45.98

14. Shtojca B – Inkasimi i THV sipas programeve dhe tabela përmbledhëse

Programi	Kodi	Realizimi 2025 (€)	Realizimi 2026 (€)	Diferenca 2026–2025 (€)
Administrata	16332	39,035.00	41,391.00	+2,356.00
Prokurimi		0.00	3,500.00	+3,500.00
Buxheti	17532	237,228.81	241,566.87	+4,338.06
Tatimi në pronë	17572	1,415,021.82	1,010,678.16	-404,343.66
Shërbimet publike	18032	3,383.00	9,228.17	+5,845.17
Pylltaria	47112	1,415.33	4,618.01	+3,202.68
Shërbimet Kadastrale	65160	104,388.00	94,283.00	-10,105.00
Planifikimi Urban	66465	3,988,371.57	605,867.34	-3,382,504.23
Shërbimet e kujdesit primar shëndetësor	74900	59,578.00	63,475.50	+3,897.50
Shërbimet kulturore	85032	1,946.00	1,497.00	-449.00
Teatri	85223	780.10	1,214.50	+434.40
Arsimi parafillor – çerdhet	92830	81,294.50	81,585.40	+290.90
Arsimi i mesëm	95130	1,665.00	6,655.00	+4,990.00
Shkolla e mesme “Pjetër Bogdani”	95132	6.00	36.00	+30.00
Totali THV		5,934,113.13	2,165,595.95	-3,768,517.18

Burimi / Kategoria	Buxheti / Vlera (€)	Shpenzimi / Realizimi (€)	%
Pagat dhe Mëditjet	23,623,853.00	13,628,879.02	57.69
Mallra dhe Shërbime	11,519,945.00	9,226,606.73	80.09
Komunale	1,010,982.00	975,240.73	96.46
Subvencione	2,500,000.00	978,797.72	39.15
Investime Kapitale	14,413,714.00	10,518,819.16	72.98
Totali i shpenzimeve	53,068,494.00	35,328,343.36	66.57
Granti Qeveritar (GQ)	45,408,225.00	33,871,741.19	95.88
Të hyrat vetanake (THV)	7,660,269.00	1,456,602.17	4.12

Burimi: Të dhënat financiare të Komunës së Ferizajt, Janar–Qershor 2026.